

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-24-2329-5-2-1/C1387

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

BAJRAM HA.GASHI B.L., Suharekë, SUHAREKË, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel me numër identifikues: 622-24-2329-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel**

No.	Lot
1	Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **15,350.40 € (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë euro e dyzet cent)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	15.08.2024
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Bajram Gashi
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	15.08.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-2329-5-2-1/C1387

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 3 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Edin Shehu Drejtor në DAP Menaxheri i Kontratës është: Xhevdet Dervishaj Ecc në DAP
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-2329-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **BAJRAM HA.GASHI B.I., Suharekë, 23000, SUHAREKË, Kosovë**

E-mail: **bging2011@gmail.com**

Personi kontaktues: **Bajram Gashi**

Telefoni: **049/356164**

Faxi:

Numri fiskal: **811038498**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-2329-5-2-1

Titulli i kontratës: Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel

3. Çmimi total i tenderit është:

15,350.40 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë **Euro**]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNIMEVE NDËRTIMORE
NË NDËRTIMIN E SIMBOLIT TË ODËS NË KRUSHË TË VOGËL**

A

PUNËT PREGADITORE

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
-----------------------	--------	-------	-------	--------

1	Pastrimi i terrenit dhe shenjëzimi-piketimi i vendit për ndërtimin e objektit në kordinim me autoritetin kontraktues.	m ²	30,00	15,00 €	450,00 €
2	Furnizimi, transportimi dhe montimi i tavolinës së armiruesve së bashku me mbulesën perkatëse si dhe elementet e tjera teknike të nevojshme për ti realizuar punimet ndërtimore. Të njëjtat duhet të demontohen pas përfundimit të punimeve.	m'	5,00	75,00 €	375,00 €

Gjithsej punët pregaditore

825,00 €

B

PUNËT TOKËSORE

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
-----------------------	--------	-------	-------	--------

1	Gërmimi me makineri ose me dorëi dheut (humusit) dhe zhavorit aktual në parcelë për të krijuar hapsirën e vendosjes së bazamentit të simbolit dhe transportimi deri në deponinë e paraparë për grumbullim.	m ³	12,00	20,00 €	240,00 €
2	Furnizimi, transportimi, planifikimi, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-63mm me trashësi d=20cm me precizitet ±2 cm nën themel pllakë të objektit.	m ³	11,00	20,00 €	220,00 €
3	Mbushja me gurë të thyer 0 - 32mm dhe nivelizimi definitiv i bazës i ngjeshur me viberpllakë si dhe pas përfundimit të bazamentit mbushja me zhavor për rreth hapsirës sipas kuotave të nevojshme në terren.	m ³	4,00	24,00 €	96,00 €

Gjithsej punët tokësore

556,00 €

C

PUNËT E BETONIT DHE BETONARMESË



	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi dhe betonimi i shtresës nën themelet pllakë, d=5cm me beton të varfër C-15/20 sipas projektit.	m ³	1,00	180,00 €	180,00 €
2	Furnizimi dhe betonimi i themeleve pllakë të simbolit, me beton të armuar C-25/30 sipas projektit.	m ³	2,00	200,00 €	400,00 €
3	Furnizimi, kallëpimi dhe betonimi i mureve të simbolit të masakrës me beton të armuar C-30/37 sipa projektit.	m ³	4,00	200,00 €	800,00 €

Gjithsej punët e betonit dhe betonarmesë

1.380,00 €

D PUNËT E ARMIMIT

	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi, transportimi, prerja, lakimi dhe montimi i armaturës sipas planit të armaturës të paraparë me llogari statike. Ø 8 S-400/500H dhe Ø 10 S-400/500H	kg	700,00	1,80 €	1.260,00 €

Gjithsej punët e armimit

1.260,00 €

E PUNËT E MERMERIT

	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi, dhe vendosja e mermerit në të gjitha faqet e jashtme dhe pjesën e sipërme të simbolit të masakrës (klasa e parë) me trashësi d=2cm me ngjyrë të bardhë, tipi i mermerit Thassos apo i ngjashëm dhe dizajn sipas kërkesës të organit mbikqyrës. Vendosja bëhet me ngjitës special dhe me ankerim, mbushja e fugave me kujdes për të mos lënë njolla në mermer.	m ²	7	200,00 €	1.400,00 €



2	Furnizimi,dhe vendosja e mermerit në faqet ku do të vendosen shkronjat e gavrura në pjesën e poshtme për historikun e masakrës (klasa e parë) me trashësi d=3cm me ngjyrë të bardhë, tipi i mermerit Thassos ose i ngjashëm i poliruar me kënd 45 shkallë në katër anë, modeli i mermerit paraprakisht duhet të aprovohet nga organi mbikqyrës. Vendosja bëhet me ngjitës special dhe mbushja e fugave me kujdes për të mos lënë njolla në mermer.	m ²	5	220,00 €	1.100,00 €	✓
3	Furnizimi dhe vendosja e Granitit mbi muret rrethuese të betoni (polisë-klasa e parë) me trashësi d=3cm me ngjyrë të zezë dhe dizajn sipas kërkesës së projektuesit. Poliset duhet të jenë të poliratura në dy anët dhe të kenë pikoret në pjesën e poshtme. Vendosja bëhet me ngjitës special dhe mbushja e fugave me kujdes për të mos lënë njolla në granit.	m ²	2,5	250,00 €	625,00 €	✓
Gjithsej punët e qeramikës					3.125,00 €	✓

F	PUNËT E NDRYSHME
----------	-------------------------

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali	
1 Furnizimi, transporti dhe punimi i pllakës për vendosjen e dy flamujve. Në çmim të përfshihet gërmimi i hapësirës, shtruarja e zhavorit, ngjeshja, armimi dhe betonimi i pllakës me dimensione 150cm me 100cm dhe trashësi 20cm duke lënë edhe 2 kapset për shtyllat metalike të ankeruara në pllakë. Në këtë pozicion të përfshihen edhe 2 shtylla metalike me lartësi 6metra të ngjyrosura me mekanizmin e flamurit, kavon dhe sistemin për ngritjen e flamurit etj deri në finalizim.	cope	2	200,00	400,00 €	✓



2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shkronjave të arëzuara me dimensione 7cm. Shkronjat duhet të jenë nga metali i arëzuar me kapëse metalike të cilat duhet të shpohen në mermer si dhe poashtu duhet të përdoret ngjitesi special. Cmimi duhet të jipet për cope të shkronjës deri në finalizim.	cope	207	10,00	2.070,00 €	✓
3	Furnizimi, transporti dhe prerja e Granitit me CNC me trashësi t=3cm i cili ka ngjyrë të zezë dhe duhet të krijohet Silueta e Martirëve nëpërmes prerjes së 29,16metrave gjatësi me CNC sipas projektit për të arritur formën artistike të siluetës së Martirëve. Ky pozicion duhet të punohet pa shkëputje dhe me aprovim paraprak me projektuesin dhe organin mbikqyrës. Pas prerjes graniti duhet të vendoset në vendin adekuat sipas projektit deri në finalizim. Cmimi të jipet me m2 mirëpo në cmim nuk llogaritet firja-pjesa e mbetur e granitit.	m ²	7,48	250,00	1.870,00 €	✓
3	Furnizimi, transporti dhe punimi i simbolikës së dyerve hyrëse nga konstruksioni metalik me profile 5x3cm me trashësi 4mm. Pas krijimit të konstruksionit nga profilet metalike, dyert duhet të vishen me llamarinë në 6 anët me trashësi 4mm. Në cmim të përfshihet ngjyrosja me 1 shtresë bazë dhe një shtresë ngjyrë përfundimtare të zezë me pjekje për ti rezistuar kushteve atmosferike. Pozicioni duhet të punohet me kujdes të shtuar pasi që është fokusi kryesor i simboliut dhe duhet të aprovohet para vendosjes në vepër.	kg	177	6,00	1.062,00 €	✓
4	Furnizimi, transporti dhe punimi i kornizës sipas detaleve në projekt me profile 5 cm X 15cm x 4mm për të krijuar formën artistike duke përfshirë edhe ngjyrosjen me dy shtresa ngjyre dhe pjekje të saj për të qenë rezistente ndaj kushteve atmosferike.	m'	14,54	60,00	872,40 €	✓



5	Furnizimi, transportimi dhe vendosja e 6 dritave në pjesën horizontale të memorialit në formë rrethore me diamter 8cm. Dritat duhet të jenë për përdorim të jashtëm të vendosura horizontalisht në pllake, rezistente ndaj ujit, ngjyra e ngrohtë e ndriqimit led me ndriqim nga poshtë lartë. Në këtë cmim duhet të parashihet edhe kablli 20metra, siguresat, ndërprerësi dhe komplet lidhja e sistemit elektrik të dritave deri në finalizim,	cope	6	200,00	1.200,00 €
Gjithsej punët e ndryshme					7.474,40 €


G PUNËT E HIDROIZOLIMIT

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1 Furnizimi, transporti dhe punimi i hidroizolimit horizontal nën pllakën e themelit me këto shtresa: 1. 1 lyerje me bitulit + 1 shtresë kondor 4mm dhe folia mbrojtëse.	m ²	6	5,00 €	30,00 €
Gjithësej punët e hidroizolimit				30,00 €

H PUNËT PËR RREGULLIMIN E PARTERIT

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1 Heqja, gryerja dhe largimi i materialit për parter me thellësi 30 cm, këtu hyn edhe gryerja, nivelizimi i bazës ekzistuese sipas kuotave me saktësi deri 2cm dhe ngjeshja e nënbazës. Në hapësirat e parapara me kubëza në cmim të llogaritet gropimi, ngarkimi dhe transporti i tij deri në deponinë e qytetit në largësi deri në 10km.	m ³	6,00	50,00	300,00 €
2 Furnizimi, transporti dhe montimi i dy shtyllave metalike me lartësi 8 metra bashkë me ndriquesin, kabllat, trupin metalik, bazamentin, etj deri në finalizim për ndriqim publik rreth hapsirës së simbolit.	copë	2,00	200,00	400,00 €

Gjithsej punët e rregullimit të parterit	700,00 €
--	----------



REKAPITULIM I PUNIMEVE NDËRTIMORE

A	PUNËT PREGADITORE	825,00 €
B	PUNËT TOKËSORE	556,00 €
C	PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMESË	1.380,00 €
D	PUNËT E ARMIMIT	1.260,00 €
E	PUNËT E MERMERIT	3.125,00 €
F	PUNËT E NDRYSHME	7.474,40 €
G	PUNËT E HIDROIZOLIMIT	30,00 €
J	PUNET PER RREGULLIMIN E PARTERIT	700,00 €

GJITHSEJ PUNËT NDËRTIMORE	15.350,40 €
---------------------------	-------------

REKAPITULIM I PUNIMEVE	15.350,40 €
------------------------	-------------





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **125596**

Për **KUVËNDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Bajram Ha. Gashi B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel**

Nr. prokurimit: 622-24-2329-5-2-1 , Nr. brendshëm: //

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,535.04€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,535.04€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 90 ditë kalendarike prej **14.05.2024** deri më **12.08.2024**

Data lëshimit: 15.05.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni



Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr.19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **125596**

Kontraktuesi	
Emri	Bajram Ha. Gashi B.I.
Përfaqësuar nga	Bajram Gashi
Adresa	Dubravë
Nr i Biznesit	811038498
Telefoni	044356164

Përfituesi	
Emri	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
Adresa	PRIZREN

Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB

Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	1,535.04
Periudha Sigurimit	14.05.2024 - 12.08.2024
Primi	27.63
Tvsh	4.97
Primi Bruto	32.60
Data e lëshimit	15.05.2024 08:32

Aktiviteti Ekonomik:
Ndërtimi i pllakës përkujtimore për Sejdi Batusha në fshatin Krushe e Vogel

Lënda e Garancisë	
Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:	
1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.	
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.	
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).	
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.	
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)	

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Blerona Suka - 3737



Përfaqësuesi i të siguarit
Bajram Gashi